



NJOFTIM

Konsultim Publik për amandamentimin e Rregullës për Autorizim për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese,

Rregullës për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës edhe

Raportin shqyrtues për përcaktimin e nivelit të tarifës nxitëse për energjinë solare

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) njofton të gjitha palët e interesuara se në pajtim me kompetencat dhe obligimet e përkufizuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energji dhe Ligjin për Energji Elektrike, ka filluar konsultimet publike për nivelin (çmimin) e tarifave nxitëse për energjinë solare (fotovoltaike). Me këtë qëllim ka publikuar raportin shqyrtues ku ka paraqitur metodologjinë e përcaktimit të tarifave nxitëse dhe vlerësimet e ZRRE-së për tarifën nxitëse për energjinë solare.

Gjithashtu ZRRE sot ka filluar procesin për amandamentim të rregullës për Autorizim për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese dhe Rregullës për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për pranim në Skemën Mbështetëse.

Raporti shqyrtues për nivelin e tarifave nxitëse dhe dy Rregullat do të jenë publike në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së www.ero-ks.org dhe ZRRE fton të gjitha palët që të japin kontributin e tyre përmes komenteve të dërguara me titull “Komente për tarifën nxitëse për energjinë solare” ose “Komente për Rregullën e Amortizimit” ose “Komente për Rregullën e Certifikatës së Origjinës” deri të premtën me 31 tetor 2014 ora 16:00, në adresën elektronike info@ero-ks.org ose në adresën postare Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë.